



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2023:216517

Datë: 28.12.2023

Numri i dokumentit: 05136193

PPP. nr. 662/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË GLLOGOC Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Astrit Gashi dhe me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Remzi Duli, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit V.G nga Komuna e Gllogocit kundër debitorit M... Sh.P.K- të cilën e përfaqëson drejtori i saj N.K nga Prishtina, lidhur me Kthimin në vendin e punës, duke vendosur në prapësimin e ushtruar nga debitori kundër urdhërit për lejimin e përmbartimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Gllogoc Cp.nr. 662/23 të datës 29.11.2023, jashtë seancës me datën 27.12.2023 e mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET prapësimi i debitorit M... sh.p.k, kundër urdhërit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Gllogoc nën shenjën Cp. nr. 662/23 i datës 29.11.2023, me të cilin është lejuar propozimi i kreditorit V.G, për përmbartimin dhe kthimin në vendin e punës, ndërsa urdhëri i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Gllogoc nën shenjën Cp. nr. 662/23 i datës 29.11.2023 **mbetet në fuqi.**

A r s y e t i m

Kreditori V.G nga Komuna e Gllogocit ka parashtruar propozim Gjykatës Themelore ne Prishtine Dega Gllogoc për lejimin e përmbartimit në bazë të Urdhërit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Gllogoc Cp.nr.662/23 i datës 29.11.2023 lidhur me kompensimin e të ardhurave personale dhe kthimin ne vendin punës.

Gjykata Themelore ne Prishtinë Dega Gllogoc, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit, ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të Aktgjykimit te Gjykatës Themelore ne Prishtinë-Dega në Gllogoc C.nr.870/20 i datës 03.02.2021 i plotëfuqishëm prej datës 12.09.2023, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë nën shenjën Ac.nr.1768/21 i datës 12.09.2023.

Debitori ka paraqitur prapësim kundër urdhërit për lejimin e përmbartimit në afatin ligjor vetëm sa i perket pikës IV të aktgjykimit i cekur ne Urdhërin përmbartimor Cp.nr.662/2023 të datës

29.11.2023 dhe atë sa i perket kthimit në vendin e punës të Kreditores V.G pasi që konsideron se: *nuk i plotëson kushtet faktike e as juridike që e njëjta të kthehet në vendin e punës për shkak se fillimisht të njëjtës i është cituar njoftimi për largimin nga puna për shkak të shkeljeve disiplinore e që ka marr vërejtje me gojë disa herë nga punëdhënësi, pastaj ka pranuar vendimin me shkrim për shkëputje të marrëdhënies së punës dhe atë procedura e largimit është bërë konform dispozitave ligjore të ligjit të punës, andaj ka kërkuar që në vështrim të Nenit 73 par. 1 të LPP-së të aprovohet si i bazuar prapësimi i tij dhe të refuzohet si i pa bazuar urdhëri për përmbarrim i përmbarruesit privat.*

Kreditori në afatin ligjor nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se prapësimi i debitorit është pa i bazuar, ndërsa Propozimi Përmbarrimor i Kreditores dhe Urdhërin përmbarrimor Cp.nr.662/23 të datës 29.11.2023 gjykata i konsideroi si të qëndrueshme dhe atë për këto arsye.

Me shikimin e shkresave të lëndës gjykata e vërtetoi faktin se kreditori propozimin për përmbarrim e ka bërë për përmbarrimin e dokumentit të përmbarrueshëm-Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc nën shenjën C.nr.870/20 i datës 03.02.2021, i cili është vërtetuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë nën shenjën Ac.nr. 1768/21 të datës 12.09.2023 të lartëcekur, kjo për shkak të detyrimit që debitori të kthejë Kreditorin në vendin e punës në pozitën që ka pasur si Juriste në Administratën si dhe të ia paguan të ardhurat e pa paguara personale për periudhën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës prej datës 25.06.2020 deri me datën 31.10.2023 për çdo muaj nga 300 Euro neto, apo shumën e tërësishme të përcaktuar nga eksperti financiar A.B në lartësi prej 11,775.48 Euro, si dhe të ardhurat tjera që do të krijohen eventualisht pas datës 31.10.2023 e deri në kthimin e vendit të punës, të paguan në emër të kontributit pensional shumën prej 1180.80 Euro, si dhe në emër të tatimit në paga shumën prej 422.21 Euro që duhet transferuar në ATK, si dhe shpenzimet procedurës kontestimore, i cili propozim është lejuar me urdhërin e lartëcekur nën shenjën Cp. nr. 662/2023 të datës 29.11.2023 dhe i cili urdhër përmbarrimor është i bazuar me dispozitat ligjore të LPP-së për realizimin e detyrimit që rrjedh nga Aktgjykim i cekur si më lartë.

Lidhur me atë se me çfarë baze juridike caktohet përmbarrimi, se çka përmban dokumenti i përmbarrimit, se çka duhet të përmbajë një propozim për përmbarrim të dokumentit të përmbarrueshëm si në rastin konkret të vendimeve gjyqësore, si dhe kushtet ligjore për caktimin e përmbarrimit në bazë të dokumentit të besueshëm janë të përcaktuara me dispozitat ligjore të Nenit 21, 22, 29, 30, 37, 38 dhe 40 të LPP-së, ndërsa shkaqet e prapësimit janë përcaktuar në Nenin 71 të LPP-së, e në rastin konkret kemi të bëjmë me dokument të përmbarrueshëm nga Neni 22 par. 1.1 të LPP-së, nga i cili shihet se debitori i detyrohet kreditorit borxhin në fjalë.

Debitori në prapësimin e tij ka theksuar se nuk mund të kthehet në vendin e punës kreditorja për shkak se vendi i saj i punës është shuar dhe urdhëri përmbarrimor nuk i plotëson kushtet ligjore, gjykata edhe këto pretendime të debitorit nuk i aprovoj, ndërsa kreditori në anën tjetër propozimit për përmbarrim i ka bashkangjitur dokumentin e përmbarrueshëm siç është Aktgjykimi i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm C. nr. 870/20 i datës 03.02.2021 i vendosur nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc si më lartë, i cili i plotëson kushtet ligjore për të u trajtuar dokument i përmbarrueshëm në kuptim të Nenit 22 par.1.1 të LPP-së.

Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke e refuzuar prapësimin e debitorit dhe ka lënë ne fuqi urdhërin përmbarues për caktimin e përmbarimit Cp. nr. 662/2023 të datës 29.11.2023 duke u bazuar në Nenin 73 par. 3 të LPP-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Dega në Gllgoc
Departamenti i Përgjithshëm, PPP. nr. 662/23, datë 27.12.2023**

**Gj y q t a r i
Astrit Gashi**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej shtatë (7) ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën. Ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi nuk e ndalon procedurën përmbarimore përveç nëse janë dhënë garancitë për shumën e plotë të kredisë sipas Nenit 78 të LPP-së.